



Datë: 09.01.2025

11
09-01-2025

Drejtoria për Arsim

Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2088), nenit 47 pika c). Të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr.98 datë: 30.07.2012, nenit 2, 3 i Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr.83 e datës 14.06.2013, dhe në mbështetje të vendimit me numër 32 të datës 09.01.2025 aprovuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 09.01.2025 shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për ndarjen e ndihmës momentale për studentët bachelor, master, nxënës me nevoja të veçanta, financimi i transportit të nxënësve për fushat e arsimit të obliguar të cilat nuk ofrohen në komunën tonë, transportin e nxënësve në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, botime letrare të nxënësve dhe mësimdhënësve të institucioneve arsimore në Komunën e Fushë Kosovës

I. Komuna e Fushë Kosovës ndanë ndihmë momentale për studentët e Komunës së Fushë Kosovës për vitin akademik 2024/25 në të gjitha fushat e studimit.

II. Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët/nxënësit që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës pa kurrfarë dallime etnike, gjinore, fetare dhe politike.

III. Kategoritë e përfituesve janë:

1. Studentët bachelor, master;
2. Nxënësit me nevoja të veçanta;
3. Transporti i nxënësve për fushat e arsimit të obliguar të cilat nuk ofrohen në komunën tone;
4. Transporti i nxënësve në territorin e Komunës së Fushë Kosovës në linjat e caktuara:
 - Nakaradë - SHFMU "Selman Riza" Fushë Kosovë
 - Lagja e Ronollëve - SHFMU Laura Scotti" Graboc i Poshtëm
 - Harilaq - SHFMU "Bajram Curri" Sllatinë e Madhe
 - Bardh i Vogël - SHFMU "Bajram Curri" Sllatinë e Madhe
 - Harilaq i Vogël - SHFMU "Bajram Curri" Harilaq
 - Pomozotin – Shkolla Speciale "Përparimi" Prishtinë
5. Botime letrare të nxënësve dhe mësimdhënësve të institucioneve arsimore në Komunën e Fushë Kosovës

IV. Kriteret e përgjithshme për ndarjen e ndihmës momentale janë:

1. Të ketë të regjistruar vitin akademik 2024/25;
2. Nota mesatare e studimeve 7.5 e më lart;
3. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës, dëshmi letërnjoftimi;
4. Të mos jenë përsëritës të vitit akademik;
5. Për nxënësit me nevoja të veçanta, Vendimi/vërtetimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.



V. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

1. Aplikacioni sipas formës së komunës
2. Kopja e ID-së së studentit;
3. Vërtetimi se studenti ka të regjistruar vitin akademik 2024/25 (originale);
4. Certifikata e notave (originale);
5. Kopja e letërnjoftimit;
6. Konfirmimi i xhirologarisë bankare.

Për studentët me nevoja të veçanta:

Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

VI. Kriteret e përfitimit për nxënës me nevoja të veçanta:

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës dëshmi letërnjoftimi
2. Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i Komunës së Fushë Kosovës;
3. Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

VII. Kriteret e përfitimit për transportin e nxënësve për fushat e arsimit të obliguar të cilat nuk ofrohen në komunën tonë:

1. Të jetë banor i Komunës së Fushe Kosovës dëshmi letërnjoftimi;
2. Vërtetimi nga shkolla që vijon mësimin.

VIII. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

1. Formulari për aplikim sipas formës së Komunës;
2. Certifikata/ekstrakti i lindjes së fëmijës;
3. Letërnjoftimi i prindit;
4. Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
5. Konfirmimi i xhirologarisë bankare.

IX. Afati dhe mënyra e aplikimit:

1. Thirrja mbetet e hapur nga dt. 10.01.2025 deri më datën 30.01.2025;
2. Formulari i aplikimit merret në zyrën pritëse, në objektin e Komunës së Fushë Kosovës;
3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet përmes zyrës pritëse në objektin e Komunës së Fushë Kosovës;
4. Të gjitha aplikacionet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë thirrje nuk do të shqyrtohen.

